



# Udhëzues për dokumentacionin e aplikantit për IDNYC



Për të aplikuar për një kartë IDNYC, duhet të përmbushni kriteret e mëposhtme:

1. Të paktën 4 pikë të akumuluar nga dokumentet, me të paktën 3 pikë për vërtetimin e identitetit dhe të paktën 1 pikë për vërtetimin e banimit në qytetin e Nju-Jorkut.
2. Të paktën 1 nga dokumentet e dorëzuara duhet të ketë një foto, me përjashtim të rastit kur aplikanti shoqërohet nga një kujdestar.
3. Të paktën 1 nga dokumentet e dorëzuara duhet të përfshijë datëlindjen.
4. Aplikantët duhet të jenë të paktën 10 vjeç për të aplikuar për një kartë IDNYC. Aplikantët e moshave 10 - 13 vjeç duhet të jenë të shoqëruar nga një kujdestar i cili nënshkruan aplikimin në emër të tyre. Për më shumë informacion, referojuni seksionit "Kujdestari" në faqen 2 të këtij dokumenti.

Nuk do të pranohet asnjë dokument i pavlefshëm nëse nuk është specifikuar ndryshe më poshtë.

Do të pranohen vetëm dokumentet dhe kopjet origjinale të vërtetuara nga agjencia lëshuese; dokumentet e plastifikuara do të pranohen vetëm nëse janë lëshuar fillimisht në gjendje të plastifikuar.

## MË POSHTË ËSHTË NJË LISTË DOKUMENTESH QË MUND T'I PËRDORNI PËR TË APLIKUAR PËR KARTËN IDNYC. DOKUMENTET ME YLL (\*) VLEJNË SI VËRTETIM DATËLINDJEJE.

### INFORMACIONE TË TJERA MUND TË GJENDEN NË FAQEN E INTERNETIT TË IDNYC NË WWW.NYC.GOV/IDNYC. PËR UDHËZIME NË LIDHJE ME APLIKIMIN SHIHNI PJESËN E PASME TË APLIKIMIT PËR IDNYC.

#### Dokumente me katër (4) pikë - Dokument identifikimi dhe vërtetim banimi

- Leje drejtimi, leje drejtimi për kursantët ose dokument identifikimi për jo drejtuesit nga Departamenti i Automjeteve Motorike (DMV) i shtetit të Nju-Jorkut me adresën aktuale në qytetin e Nju-Jorkut. Në rast se leja e drejtimit/ leja e drejtimit për kursantët/ dokumenti i identifikimit për jo drejtuesit të lëshuar nga DMV i shtetit të Nju-Jorkut kanë skaduar, ato do të pranohen nëse shoqërohen nga një dokument i barasvlerëshëm i përkohshëm me të njëjtin numër identifikimi.\*
- Leje drejtimi ose dokument identifikimi për jo drejtuesit nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara me adresën aktuale në qytetin e Nju-Jorkut\*
- Kartë IDNYC me adresën aktuale të banimit\*
- Leje për armëmbajtje të armëve të ndaluara nga Departamenti i Policisë së Qytetit të Nju-Jorkut (NYPD) me adresën aktuale në qytetin e Nju-Jorkut\*
- Aplikim për kartë IDNYC në shkollë nëntëvjeçare i nënshkruar nga kujdestari që është paraqitur për regjistrimin në shkollë dhe i verifikuar nga Departamenti i Arsimit (DOE)

#### Dokumente me tre (3) pikë - Dokument identifikimi

- Pasaportë ose kartë-pasaportë e SHBA-së\*
- Pasaportë e huaj (biometrike)\*
- Leje drejtimi ose leje drejtimi për kursantët me fotografi e SHBA-së\*\*
- Kartë identiteti e SHBA-së\*
- Leje e përhershme qëndrimi (Green Card) e SHBA-së\*
- Vërtetim i nënshtetësisë amerikane ose natyralizimit\*
- Pasaportë lundrimi e marinarit të flotës tregtare e SHBA-së\*
- Leje drejtimi ose dokument identifikimi për jo drejtuesit nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së pa adresën aktuale\*
- Dokument identifikimi i shkelësit të liruar nga Departamenti i Administrimit të Burgjeve dhe Mbrojtjes së Komunitetit (DOCCS) të shtetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda vitit të fundit)\*
- Dokument identifikimi për kalimin e sigurt të përfaqësuesve ligjorë në sistemin e unifikuar të gjykatave nga shteti i Nju-Jorkut\*
- Kartë e aksesit të zakonshëm (për personelin aktiv, personelin që ka dalë në pension apo atë rezervist)\*
- Leje e vlefshme pune në territorin e SHBA-së\*
- Kartë e identifikimit e prejardhjes fisnore e SHBA-së\*
- Kartë e transferimit elektronik të përfitimeve (EBT)/CBIC me fotografi\*
- Kartë IDNYC pa adresën aktuale të banimit\*

#### Dokumente me dy (2) pikë - Dokument identifikimi

- Pasaportë e huaj (jo biometrike)\*
- Pasaportë ose kartë-pasaportë e skaduar e SHBA-së (e skaduar prej jo më shumë se 3 vitesh; biometrike)\*
- Pasaportë e huaj e skaduar (e skaduar prej jo më shumë se 3 vitesh; biometrike)\*
- Kartë identiteti konsullorë\*
- Kartë identiteti e veteranit e SHBA-së e lëshuar nga "VA"
- Kartë shëndeti e veteranit e SHBA-së e lëshuar nga "VA"
- Dokument identifikimi i punonjësit federal, shtetëror ose vendor
- Certifikatë lindjeje e SHBA-së\*
- Vizë e lëshuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së\*
- Leje drejtimi e huaj (biometrike)\*

#### vazhdim... Dokumente me dy (2) pikë - Dokument identifikimi

- Kartë identiteti e huaj (biometrike)\*
- Kartë e sigurimeve shoqërore
- Kartë IDNYC e skaduar - me ose pa adresën aktuale (më shumë se 6 muaj dhe më pak se 3 vite pas datës së skadimit)
- Dokumenti i caktimit të Numrit individual të identifikimit të taksapaguesit (ITIN) i SHBA-së
- Dokument identifikimi i shërbimeve të armatosura i SHBA-së\*
- Dokument profesional identifikimi i Departamentit të Arsimit të shtetit të Nju-Jorkut
- Formular verifikimi për Programin Veror të Punësimit të të Rinjve (SYEP) (shërben gjithashtu për vërtetimin e banimit)\*
- Formular I-94 i lëshuar nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare të SHBA-së me fotografi, shenjën e gishtit dhe datëlindjen\*
- Dokument i përkohshëm i barasvlerëshëm me lejen e drejtimit, lejen e drejtimit për kursantët ose dokumentin e identifikimit për jo drejtuesit nga "DMV" i shtetit të Nju-Jorkut\*
- Njoftim miratimi për formularët I-797, I-797A, I-797B ose I-797D të lëshuar nga Shërbimi i Nënshetësisë dhe Emigracionit të SHBA-së (USCIS)
- Formular verifikimi i studentit nga Departamenti i Arsimit (DOE) të qytetit të Nju-Jorkut; në prani të kujdestarit

#### Dokumente me një (1) pikë - Dokument identifikimi

- Kartë identiteti e huaj (jo biometrike)\*
- Certifikatë lindjeje e huaj\*
- Dokument identifikimi i huaj i shërbimit ushtarak me fotografi\*
- Leje drejtimi e huaj (jo biometrike)\*
- Dokument identifikimi i institucionit arsimor: shkollë nëntëvjeçare, shkollë e mesme, universitet, kolegji dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë\*
- Formular verifikimi i studentit nga Departamenti i Arsimit (DOE) (shërben gjithashtu si verifikim banimi); duhet të paraqitet së bashku me kartën e studentit nëse studenti nuk është i shoqëruar me kujdestarin.\*
- Diplomë nga një shkollë e mesme, program ekuivalent me arsimin e mesëm apo kolegji, universitet ose institucion tjetër i arsimit të lartë i SHBA-së
- Listë notash e shkollës së mesme apo kolegjit, universitetit ose institucionit tjetër të arsimit të lartë të SHBA-së
- Kartë EBT e shtetit të Nju-Jorkut pa fotografi\*
- Dokument identifikimi i SYEP i qytetit të Nju-Jorkut
- Dokument identifikimi i sindikatës i SHBA-së
- Dokument identifikimi i punonjësit, konsulentit ose anëtarit të bordit, si edhe të klerit nga organizata që ndodhen në SHBA
- Certifikatë martesë, certifikatë për lidhje martesë, vërtetim bashkëjetese apo certifikatë divorci\*
- Kartë metroje "MTA" për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara
- Karta e Access-A-Ride e MTA
- Kartë anëtarësie në qendra dhe parqe zbavitjeje për të rinjtë, të rriturit, të moshuarit dhe veteranët e qytetit të Nju-Jorkut
- Karta e votimit e SHBA-së
- Karta e Regjistrimit të Zgjedhjes së Shërbimeve e SHBA-së\*
- Karta Medicare
- Karta e taksapaguesit (ITIN) e SHBA-së
- Certifikatë lindjeje e fëmijës suaj (aplikanti duhet të jetë prindi)\*
- Karta e OMH e shtetit të Nju-Jorkut me fotografi.

## Dokumente me një (1) pikë - Vërtetim banimi

- Faturë për përdorimin e aparateve televizive, telefonit, shërbimeve utilitare (e lëshuar brenda 60 ditëve)
- Kontratë qiraje ose nënqiraje në pronën aktuale
- Deklaratë e taksave vendore mbi pasurinë e paluajtshme (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Vërtetim pagese i hipotekës së pronës (i lëshuar brenda 60 ditëve)
- Faturat, pasqyrat ose njoftimet bankare, financiare ose të llogarisë së kartës së kreditit (të lëshuara brenda 60 ditëve). Duhet të përfshijë numrin e llogarisë ose numrin e identifikimit të klientit.
- Listëpagesë që detajon pagën (e lëshuar brenda 60 ditëve)
- Deklaratë, faturë ose vërtetim nga një institucion shëndetësor (lëshuar brenda vitit të fundit). Duhet të përfshijë numrin e llogarisë ose numrin e identifikimit të pacientit.
- Thirrje ose urdhër gjykate i lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut (duke përfshirë gjykatat e qytetit të Nju-Jorkut) ose gjykata federale (e lëshuar jo brenda 60 ditëve)
- Formularët IRS W-2, 1099-MISC, 1095-A, 1095-B dhe 1095-C (pranohen deri më 15 prill të vitit vijues pas vitit tatimor në formular)
- Deklaratë tatimore me vërtetim depozitimi (lëshuar brenda vitit të fundit nga data e depozitimit)
- Shkresë ose dokument i lëshuar nga IRS ose Departamenti i Tatimeve dhe Financave (DTF) i shtetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Fatura, pasqyra dhe regjistrimi i sigurimit (sigurimi i banesës, jetës, qiramarrësit, automjetit dhe shëndetit; lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Letër nga Autoriteti i Strehimit i qytetit të Nju-Jorkut NYCHA (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Shtojcë e kontratës së qiradhënies ose njoftim për pagesë qiraje nga NYCHA (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Konfirmim i ndryshimit të adresës nga USPS (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Formular i ndërprerjes së qirasë Seksioni 8 i HPD të qytetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Raport i llogaritjes së buxhetit i HRA të qytetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Karta me fotografi e pacientit të shtruar të OMH të shtetit të Nju-Jorkut.
- Formular për "Vërtetim lirim" i lëshuar nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore HHS/Zyra e Rilokalizimit të Refugjatëve ORR i SHBA-së (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Urdhër mbikëqyrjeje nga Agjencia për Emigracionin dhe Doganat (ICE) e SHBA-së (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Dokument i përkohshëm i barasvlershëm me lejen e drejtimit, lejen e drejtimit për kursantët ose dokumentin e identifikimit për jo drejtuesit nga "DMV" i shtetit të Nju-Jorkut
- Njoftim i vendimit ose përcaktimit (NOD) të aftësive të kufizuara zhvillimore lëshuar nga Zyra për Personat me Aftësi të Kufizuara Zhvillimore OPWDD e shtetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda vitit të fundit)
- Dokument për vërtetimin e vendbanimit për diplomatët e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe familjet e tyre (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Letër për prindin/kujdestarin e studentit të regjistruar në programet Head Start, Early Learn ose në cilëndo shkollë të DOE të qytetit të Nju-Jorkut (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit). Aplikanti duhet të paraqesë dëshmi për vërtetimin e marrëdhënies me studentin.
- Letër për regjistrimin e studentit në shkollë private ose katolike (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit). Aplikanti duhet të ketë një kartë studenti.
- Formular verifikimi i studentit nga DOE i qytetit të Nju-Jorkut (disponohet në shkollat e DOE). Studenti duhet të paraqesë kartën e studentit ose të regjistrohet i shoqëruar nga kujdestari.\*
- Formulari i verifikimit SYEP
- Letër nga qendra për të pastrehët e qytetit të Nju-Jorkut (ku deklarohet se aplikanti ka qëndruar aty për 15 ditë dhe se qendra i lejon rezidentët të qëndrojnë për më shumë se 30 ditë). (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)
- Marrëveshja për Qëndrimin në Konkvinin e Universitetit për aplikantët që banojnë në konvikt. Aplikanti duhet të paraqesë një kartë studenti me fotografi. Dokumenti duhet të jetë i vlefshëm.
- Letër nga Administratori i kolegjit apo universitetit që vërteton se aplikanti banon në konvikt dhe se e merr postën në një adresë tjetër të shkollës. Aplikanti duhet të paraqesë një kartë studenti me fotografi. (Duhet të jetë lëshuar brenda 60 ditëve të fundit) Adresa e specifikuar në kartë do të jetë adresa e shkollës.

**Bashkëshortët dhe partnerët bashkëjetues: Aplikantët të cilët nuk kanë mundësi të marrin një vërtetim banimi në emrin e tyre, mund të paraqesin një me emrin e bashkëshortit apo partnerit të tyre; një (1) certifikatë martesë, certifikatë për lidhje martesë apo vërtetim bashkëjetese ose (2) akti i lindjes së fëmijës që i identifikon si aplikantin ashtu dhe bashkëshortin/en apo partnerin bashkëjetues si prindërit përkatës. Aplikanti duhet të paraqesë gjithashtu një vërtetim të nënshkruar nga bashkëshorti/ja apo partneri bashkëjetues ku deklarohet se jetojnë bashkë.**

## Dokumente me një (1) pikë - Vërtetim banimi për aplikantët pa adresë banimi ose për të mbijetuarit e dhunës në familje

- Letër kujdesi nga një organizatë jofitimprurëse apo institucione fetare të qytetit të Nju-Jorkut që ofrojnë shërbime për individët e pastrehë ose të mbijetuarit e dhunës në familje. Aktualisht subjekti duhet të jetë i financuar nga qyteti i Nju-Jorkut. Në letër duhet të theksohet se aplikanti ka marrë shërbime nga subjekti gjatë 60 ditëve të kaluara dhe mund ta përdorë adresën e subjektit për qëllime postare (lëshuar brenda 14 ditëve të fundit). Adresa në kartë do të jetë adresa e organizatës.
- Letër nga agjencitë e qytetit, organizatat jofitimprurëse apo institucione fetare të qytetit të Nju-Jorkut që ofrojnë shërbime për individët e pastrehë (e lëshuar jo më parë se 30 ditë). Në kartë nuk do të shfaqet asnjë adresë.

## vazhdim... Dokumente me një (1) pikë - Vërtetim banimi për aplikantët pa adresë banimi ose për të mbijetuarit e dhunës në familje

- Letër nga qendra për të pastrehët e qytetit të Nju-Jorkut (duhet të deklarohet se aplikanti ka qëndruar aty për 15 ditë dhe se qendra i lejon rezidentët të qëndrojnë për më shumë se 30 ditë) (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit) Në kartë vendoset adresa e qendrës.
- Letër nga programi i kujdesit rezidencial për viktimat e dhunës në familje, e lëshuar brenda 30 ditëve. Karta mund të mos ketë adresë të shënuar ose mund të ketë adresën e kulisë postare të programit.
- Letër nga agjencitë e qytetit, organizatat jofitimprurëse apo institucione fetare të qytetit të Nju-Jorkut që ofrojnë shërbime për të mbijetuarit e dhunës në familje (e lëshuar brenda 30 ditëve). Në kartë nuk do të shfaqet asnjë adresë.
- Letër e lëshuar nga një spital apo klinikë shëndetësore e qytetit të Nju-Jorkut (e lëshuar brenda 30 ditëve). Në kartë nuk do të shfaqet asnjë adresë.

## Si të veproni nëse nuk keni dokumentacion të mjaftueshëm

- Keni ende mundësi për të aplikuar për kartën "IDNYC". Nëse keni lindur në qytetin e Nju-Jorkut, përfitonit asistencë ekonomike, asistencë nga programi "SCRIE", nëse jetoni në një nga ndërtesat e "NYCHA" dhe/ose nëse nuk keni një vendbanim të qëndrueshëm, flisni me një nga anëtarët e personelit tonë të qendrës së regjistrimit.

## Marrëdhënia me kujdestarin - Vërtetim i marrëdhënies midis kujdestarit dhe aplikantit

**Aplikanti duhet gjithashtu të sigurojë të paktën 2 pikë për vërtetimin e identitetit, ku të përfshihet edhe datëlindja. Kujdestari duhet të sigurojë të paktën 3 pikë nga vërtetimi i identitetit të tij, ku të përfshihet edhe një mjet identifikimi me fotografi. Moshat e aplikantëve që mund të paraqesin një prej këtyre dokumenteve janë shënuar midis kllapave.**

- Certifikatë lindjeje e aplikantit (deri në 21 vjeç)\*
- Vendim adoptimi, certifikatë adoptimi ose raport adoptimi nga Departamenti i Shëndetit i Shtetit të Nju-Jorkut (DOH) (deri në 21 vjeç)\*
- Formular për pranimin e atësisë i lëshuar nga DOHMH i qytetit të Nju-Jorkut dhe OTDA i shtetit të Nju-Jorkut (deri në 21 vjeç)\*
- Letër nga "ACS" ose një agjenci kujdesi tutorial e "ACS" (deri në 21 vjeç). Kujdestari duhet të paraqesë një mjet identifikimi "ACS" ose një mjet identifikimi si punonjës i agjencisë.\* Shërben gjithashtu si vërtetim banimi. (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit)\*
- Vërtetim që kujdestari është prindi kujdestar i ligjshëm dhe letër nga agjencia e kujdesit tutorial ku deklarohet se kujdestari është prindi kujdestar i aplikantit. (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit; deri në 21 vjeç)\*. Shërben gjithashtu si vërtetim banimi.
- Urdhër gjykate atësie/origjine (deri në 21 vjeç)\*
- Certifikatë lindjeje e aplikantit dhe certifikatë martesë e njerkut/njerkës, e lidhjes në gjendje civile ose bashkëjetesës (deri në 21 vjeç)\*
- Formular për "Vërtetim lirim" i lëshuar nga HHS/ORR i SHBA-së (deri në 21 vjeç)\*
- Urdhër gjykate të huaj që e cakton kujdestarin si kujdestar ligjor të aplikantit (deri në 21 vjeç)\*
- Urdhër gjykate i SHBA-së që e cakton kujdestarin si kujdestar ligjor, prind birësues apo mbrojtës të ligjshëm të aplikantit (pa kufizim moshe)\*
- Njoftim i vendimit ose përcaktimit (NOD) të aftësive të kufizuara zhvillimore i lëshuar nga OPWDD i shtetit të Nju-Jorkut (pa kufizim moshe)\*
- Letër nga një institucion i kujdesit rezidencial i drejtuar, licencuar, certifikuar ose themeluar nga OPWDD, OMH, DOH ose DOHMH i shtetit të Nju-Jorkut. (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit; pa kufizim moshe) Kujdestari duhet të paraqesë mjetin e identifikimit të punonjësit. Shërben gjithashtu si vërtetim banimi.
- Letër nga Administrata e Sigurimeve Shoqërore SSA me anë të së cilës kujdestari caktohet si Përfaqësuesi i aplikantit për pagesat (lëshuar brenda vitit të fundit; pa kufizim moshe)\*
- Letër nga "SSA" që përcakton një organizatë si Përfaqësuese të aplikantit për pagesat (lëshuar brenda vitit të fundit) DHE një letër nga organizata ku deklarohet se punonjësi/përfaqësuesi është i autorizuar të përfaqësojë aplikantin (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit; pa kufizim moshe). Kujdestari duhet të paraqesë mjetin e identifikimit të punonjësit.
- Letër nga "NYS OPWDD", "NYS DOH", "NYS OMH", "NYC DOHMH", ose një nga ofruesit e shërbimeve të tyre (lëshuar brenda 60 ditëve të fundit; pa kufizim moshe). Kujdestari duhet të paraqesë mjetin e identifikimit të punonjësit.

## Statusi i veteranit (vetëm një)

- DD 214: Certifikatë e liritimit ose shkarkimit nga detyra
- DD 2 (Në pension): Dokument identifikimi i shërbimeve të forcave të armatosura të SHBA-së (Në pension)
- VIC/VHIC: Dokument identifikimi i spitalit të veteranëve
- NGB-22: Raport i ndarjes dhe regjistrimit të shërbimit i Byrosë Kombëtare të Mbrojtjes
- Leje drejtimi ose dokument identifikimi për jo drejtuesit me status veterani nga "DMV" e shtetit të Nju-Jorkut
- Kartë IDNYC me status veterani
- Vërtetim nga Departamenti i Shërbimeve për Veteranët i qytetit të Nju-Jorkut ku konfirmohet shërbimi ushtarak
- Letër nga Departamenti i Shërbimeve për Veteranët i qytetit të Nju-Jorkut ku konfirmohet shërbimi ushtarak